



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/TH12-7 Prot.

Tiranë 18/07/2025

Nr. Dok. 202500589/ 7

Lënda: *Rekomandim për ushtrimin e kompetencave ligjore në trajtimin e ankesës së shtetasit Th.K.*

Drejtuar: Bashkisë Finiq

Finiq

Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Finiq

Finiq

Për dijeni: Z. Th.K

Finiq

Të nderuar!

Sikurse jeni vënë në dijeni nga korrespondenca jonë zyrtare, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka depozituar një ankesë z. Th.K ndaj Bashkisë Finiq, në të cilën parashtron ndër të tjera se, ai është banues në fshatin Rahullë, të Bashkisë Finiq. Në vitin 2022, banesës së tij i është shkaktuar një dëm si pasojë e rrëshkitjes së murit rrethues të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe pa asnjë kriter ndërtimi (pa themele), nga ana e komshiut të tij z. N.K, rrëshkitje e cila ka rrezikuar edhe jetën e familjarëve të tij. Banesa e ankuesit ndodhet poshtë shtëpisë së komshiut të tij, në një terren të thyer mbi 10 gradë.

Lidhur me këtë situatë ankuesi shpjegon se i është drejtuar Bashkisë Finiq, e cila fillimisht ka angazhuar punonjësit e saj, edhe më pas edhe dy inxhinierë të licensuar, njëri gjeolog dhe tjetri inxhinier ndërtimi (të cilët janë paguar nga ana e ankuesit), për të vlerësuar gjendjen faktike në terren. Bazuar në raportet e ekspertimit teknik të dy inxhinierëve, si dhe në proces verbalin e mbajtur nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Finiq, *(në vijim IMT)*, i është kërkuar shtetasit N.K të prishë murin dhe të largojë menjëherë gurët e murit që ishte prishur në kufijtë midis dy pronave kufitare, si dhe të ribëjë një mur të ri konform standarteve të ndërtimit.

Sikundër shkruan ankuesi, nga ana e komshiut të tij ende nuk janë larguar gurët dhe dherat, por vetëm është rregulluar një pjesë e murit pa asnjë standart teknik (pa themele). Madje së fundmi ai ka bërë ankesë në Bashkinë Finiq nëpërmjet së cilës fajëson ankuesin për rrëzimin e murit.

Ankuesi shpjegon se është ankuar pranë jush për të mundësuar prishjen e murit, largimin e mbeturinave dhe ribërjen e murit konform standarteve, për të mos rrezikuar më jetën e familjarëve si dhe shkatërrimin e pronës së tij. Mirëpo nga ana juaj i është kthyer përgjigje se, për shkak të rrugës së ngushtë nuk mund të çoni dot mjete prishjeje. Në këto kushte kjo problematikë nuk ka gjetur ende zgjidhje.

Sa më sipër, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme.

Pas rregjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe të përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, respektivisht nenet 13, 17 shkronja "a" dhe 18 shkronja "b", ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

-I-

Qëndrimi i Bashkisë Finiq, IMT-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, lidhur me rastin.

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështjeje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe në nenin 19, gërma "b" të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *"Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me*

hetimin”, me tonën nr. K3/TH12-2 prot., datë 14.11.2024, “kërkesë për shpjegime”, i kemi kërkuar Bashkisë Finiq, të na dërgojë një informacion sa më konkret dhe gjithëpërfshirës, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor, që ka të bëjë me çështjen objekt hetimi administrativ.

Në përgjigje tonës, me shkresën nr. 2888/1 prot., datë 26.11.2024, Bashkia Finiq, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, ndër të tjera na ka informuar se, muri i gurit i ndërtuar vite më parë nga z. N.K ishte çarrë dhe ishte shkëputur në shumë vende dhe rrëshqitja e dheut rrezikonte banesën e z. *Th.K*. Nga ana e IMT-së është mbajtur proces verbal me nr. 1549 prot., datë 15.06.2022, të cilin e ka dërguar tek Drejtoria e Planifikimit të Territorit si dhe Zyrës së Emergjencave Civile.

Në vijim shprehet se, nga ana e Bashkisë Finiq ky problem është trajtuar me rigoroze. Kështu në proces-verbalin me nr. 1660 prot., datë 28.06.2022, të mbajtur nga IMT-ja si hap i parë dhe emergjent i është rekomanduar z. N.N prishja e murit dhe largimi i menjëhershëm i gurëve të murit që kishte rrëshqitur në kufirin midis dy pronave. Në vijim keni shpjeguar se, shtetasi N.N është pajisur me *leje Ndërtimi me nr. 2042/1 prot., datë 09.08.2022, për ndërtimin e murit Mbajtës, në bazë të projektit të bërë nga ing. D.,B*, pra nuk keni të bëni me ndërtim të paligjshëm, bazuar në ligjin nr. 9780 datë 19.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”.

Në bazë të ankimit të bërë sërish nga z. *Th.K* se, ky mur nuk ishte ndërtuar konform kushteve teknike, nga ana juaj është konstatuar se *themeli nuk ishte hapur deri në fund në bazament*, por ishte hedhur një shtresë betoni. Më datë 31.10.2023, me shkresën nr.2584 prot., i keni dërguar kërkesë për bashkëpunim për rastin ing. gjeolog z. S.L i cili në raportin gjeologjik ka kërkuar *“Prishjen e murit ekzistues në të gjithë gjatësinë që përfshin kufirin e përbashkët të pronarëve Th.K dhe N.K, sipas parametrave të pasqyruara në relacionin Gjeologjik*.

Gjithashtu me shkresën nr. 366 prot., datë 13.02.2024, duke qenë se terreni ishte me pjerrësi, keni kërkuar të rishikohej nga ing. projektues dhe zbatues nëse muri ishte konform standarteve inxhinierike dhe t’ju vinte në dispozicion relacionin teknik të situatës me shkresën nr. 366 prot., datë 13.02.2024. Sipas aktit të ekspertimit teknik të hartuar nga ing. D,B më datë 20.06.2024, po ashtu është kërkuar *prishja e murit ekzistues në zonën e përbashkët dhe kthimin sheshit në gjendjen e mëparshme duke nxjerrë bazamentin e themelit dhe heqjen e materialit të dëmtuar, si dhe ndërtimin e murit të ri sipas projektit të miratuar në Bashki për marrjen e lejes së ndërtimit*.

Duke qenë se z. N.K ndodhet në emigracion (Greqi) ju shpreheni se, e keni të pamundur të bëni ndërhyrje sepse nuk keni mundësi tjetër hyrje për veprim përveç shtëpisë së tij, pasi nga ana e poshtme prona e z. *Th.K* është e rrethuar me mure guri vite më parë. *Duke parë në vend dhe hyrjen për në pronën e z. N.K situata bëhet akoma më e vështirë, pasi rruga është shumë e ngushtë dhe nuk mund të futen mjetet për prishjen e murit apo heqjen e bazave dhe dherave. E vetmja mënyrë është ndërhyrja me krahë*.

Për këtë arsye i keni kërkuar bashkëpunim Komisarariatit të Policisë Sarandë me shkresën nr.1493/1 prot., datë 03.07.2024, që shtetasi N.K të paraqitej pranë Bashkisë Finiq, duke i vënë në dispozicion dhe numrin e tij të telefonit, pasi njoftimeve tuaja të herëpashershme deri më sot nuk i është përgjigjur. Me shkresën nr 2375/1 prot datë 25.07.2024, jeni bërë me dije se nga verifikimet e bëra shtetasi N.K .ndodhet jashtë shtetit. Në vijim jeni shprehur se më datë 15.10.2024, nr. 2552 prot., keni bërë njoftim për rindërtimin e murit z. N.K, të cilin ia keni dërguar vëllait të tij z. TH.K.

-II -

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime:

Bazuar në kuadrin ligjor që rregullon legjislacionin përkatës “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit është një nga autoritetet e inspektimit të ndërtimit, i cili ushtron përgjegjësinë e tij në drejtim të kontrollit të territorit, si dhe zbatimin e ligjshmërisë së standarteve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Me qëllim mbrojtjen e territorit dhe parandalimin e punimeve dhe të ndërtimeve të paligjshme nga ana IMT-së, kryhen inspektimet përkatëse duke bërë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, në përputhje me ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, dhe të legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e Ndërtimit në Republikën e Shqipërisë”. I përcaktuar si një nga organet e inspektimit ndërtimor, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, të njëjsteve vendore, ka si përgjegjësi të tij ligjore,¹ ushtrimin e kontrollit të territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. E gjithë kjo veprimtari zhvillohet mbi bazën e proceseve verifikuese dhe vendimmarrjes sanksionuese, të parashikuara këto shprehimisht në legjislacionin në fuqi.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe në përmbushje të përgjegjësisë të parashikuara në ligj është detyrë e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit marrja e masave konkrete administrative, si: vendosja e gjobës, pezullimi i punimeve, marrja e vendimit për zhdëmtimin në ngarkim të subjektit kundravajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit si dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme; prishja e ndërtimit të paligjshëm, përgatitja e kallëzimit penal për veprat penale që mund të konstatojë gjatë ushtrimit të kontrollit, si dhe paraqitjen e tij pranë organeve përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 12, pika 8, gërma “c”, e ligjit nr.9780 datë 16.07.2007, të ndryshuar, parashikohet se:

¹ Neni 4, paragrafi i parë, i ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kanë të drejtë:

*c) të përfshijnë në kontrollin e tij prishjen e një ndërtimi ekzistues, ndërtimin apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore, si dhe **punimet/ndërtimet, që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve**”.*

Ndërsa në ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, në pikën 20, 21 dhe 22, të nenit 3, si dhe në pikën 1, 2, të nenit 39, është parashikuar se:

20. “Ndërtim” është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë”,

21. “Ndërtim/punim pa leje”, janë ato procese dhe/ose projekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e lejes së shfuqizuar”,

22. “Ndërtim në shkelje të lejes” janë punime dhe/ose ndërtime të kryera në shkelje të kushteve dhe kritereve teknike dhe/ose ligjore të lejes, pavarësisht krijimit të volumeve ose shtesave në ndërtim.

1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41, i këtij ligji”.

2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të kërkesave dhe normave e standarteve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tij.

Në pikat 1-3, të nenit 51, të po këtij ligji, parashikohet se:

“1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar”.

Ndërsa, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 894 datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”, në gërmën “a”, të nenit 1, përcakton se kompetencat e dhëna në këtë akt nënligjor për kryeinspektorët/inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore, përcaktohen në mbështetje të nenit 12, të ligjit nr.9780 datë 16.07.2007, i ndryshuar.

Në vijim në nënërmat “ii” dhe “iv”, të gërmës “b”, të pikës 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 894 datë 4.11.2015, parashikon në mënyrë eksplicite se:

“b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

- ii) kryen kontrolle në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike;*
- iv) përfshin në kontrollin e tij punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, prishjen e objektit, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, **infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi”.***

Lidhur me rastin në fjalë ka rezultuar se:

Për shqyrtimin e ankesës së bërë nga ankuesi *Th.K* më datë 13.06.2022, pranë Bashkisë Finiq, për rrëshqitjen e murit të komshiut të tij nga rreshjet e shiut, shtetasit N.K, i cili rrezikonte banesën si dhe jetën e familjarëve të tij, është ngritur Komisioni i vlerësimit të gjendjes teknike të murit i cili kishte rrëshqitur dhe marrjen e masave për evitimin e pasojave, bazuar në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.108 datë 21.06.2022.

Më datë 27.06.2022, Komisioni ka shkuar në fshatin Rahullë për vlerësimin e gjendjes teknike të murit dhe masave për evitimin e dëmeve materiale dhe njerëzore që mund të shkaktonte rrëzimi i murit, i ndërtuar nga z. N.K. Grupi i punës ka konstatuar se, z. N.K në periudhë të panjohur ka ndërtuar një mur mbajtës në skarpatën juglindore të oborrit të ankuesit *Th.K*. Ky mur është ndërtuar pa leje ndërtimi dhe pa një projekt të mirëfilltë konstruktiv. Poshtë këtij muri me terren të pjerrët ndodhet familja e z. *Th.K* në distancë horizontale rreth 5 m dhe altimetrike po 5 metra. Si rezultat i shirave të forta, lagështirës lartësisë së madhe të skarpatës, presionit horizontal dhe vertikal i mbushjeve para murit mbajtës që ka bërë që muri të çahet vertikalisht si dhe në disa sektorë pjesët fundore të tij kanë rrëshqitur duke dalë totalisht jashtë pune, gjithashtu janë vërejtur fryrje dhe plasaritje të cilat nga kqyrja dhe analiza në vend çonin përcaktueshmërisht në një rrëshqitje të pashmangshme.

Komisioni ka vlerësuar që rrëshqitja do të ishte e tillë që do të krijonte një valë goditëse shumë të madhe duke kaluar rrezen e 10 m për shkak edhe të terrenit të pjerrët dhe lartësisë së tij të madhe në krahasim me kuotën në të cilën ndodhet banesa e shtetasit *Th.K*. Shpërthimi i këtij

muri do të ishte me përmasa të një rrezikshmërie të lartë të padiskutueshme për familjen që ndodhet poshtë tij².

Sikurse rezulton edhe nga proces verbali nr. 1660 prot., datë 28.06.2022, si hap të parë dhe emergjent grupi i punës ka rekomanduar *prishjen e murit që ka rrëshqitur dhe largimin e menjëhershëm dhe të detyrueshëm të gurëve të prishjes së murit që ka rrëshqitur si fazë e parë për garantimin e sigurisë njerëzore.*

Sa sipër shtetasi Th.K urgjentisht duhej të merrte masa që të largonte gurët e murit të dalë jashtë pune me qëllim evitimin e dëmeve njerëzore si dhe lehtësimin e ngarkesave të cilat ushtrojnë presion rrëshqitës deri në marrjen e masave konstruktive dhe i është lënë një *afat një javor për largimin e gurëve dhe pastrimit të territorit. Më tej jeni shprehur se nëse nuk respektohet afati i mësipërm, do të ndërhyjë bashkia kundrejt faturimit të kostos financiare shtetasit N.K.*

Edhe pse afati i mësipërm i lënë për pastrimin e territorit nuk është respektuar nga shtetasi N.K, nga ana juaj rasti nuk është ndjekur me prioritet dhe në vazhdimësi, pavarësisht se ky ndërtim paraqiste rrezik shembje që mund të kishte pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve si dhe mbi pasurinë e të tretëve. Kështu nuk keni ushtruar kontroll në vijimvsi duke mos ushtruar përgjegjësitë tuaja konform nenit 12, pika 8, gërma “c”, të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar.

Vlerësojmë se në rastin në fjalë me qëllim zgjidhjen e problematikës ka qenë e nevojshme ndërhyrja konkrete e IMT-së Bashkisë Finiq, sikurse rezulton edhe nga shkresa nr. 1438 prot., datë 10.09.2022, e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Finiq, e cila ka rekomanduar *ndërhyrjen fizike nga ana e Bashkisë Finiq në drejtim të prishjes së murit ekzistues i cili është në gjendjen e rrezikut të rrëshqitjes, pastrimin e gurëve duke i nxjerrë jashtë rrezes së rrezikshmërisë për banesën e shtetasit Th.K, kundrejt faturës financiare. Kjo pasi pritet që të nisin edhe rreshjet e shiut të cilat e favorizojnë rrëshqitjen.*

Gjithashtu në kuadër të përfundimit të plotë të procedurës administrative nga ana juaj duhet të kishte një vendimarrje për zhdëmtim në ngarkim të subjektit N.K për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme.

Është mëse evidente që mospërfundimi i plotë i procedurës administrative lidhur me rastin në fjalë dhe mosushtrimi i përgjegjësiave ligjore nga ana juaj ka ndikuar që dhe pas rreth tre vitesh të ekzistojë akoma gjendja e rrezikut si rezultat i rrëshqitjes së murit dhe shembjes së tij, i cili mund të shoqërohet me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Sikurse rezultoi nga hetimi administrativ, pas konstatimit të situatës së rrëshqitjes së murit nga ana juaj, shtetasi N.K fillimisht ka filluar ndërtimin e murit pa asnjë leje ndërtimi dhe pa asnjë projekt të miratuar. Lidhur me këtë fakt ju jeni vënë në dijeni sërish nga ankesa që ka bërë

² Shkresa nr nr.1438 prot., datë 14.06.2024 e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkisë Finiq.

shtetasi Th.K. Nga ana juaj lidhur me këtë situatë më datë 08.08.2022, është mbajtur proces-verbali për konstatimin e kundërvajtjes administrative për kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi dhe është bërë pezullimi i punimeve me qëllim që shtetasi N.K, të pajiset me leje ndërtimi konform legjislacionit në fuqi.

Në rrethanat e parashtruara sa sipër, vlerësojmë se përsëri nga ana juaj nuk është ndjekur e plotë procedura ligjore administrative. Pavarësisht se është konstatuar kundërvajtja për kryerjen e punimeve lidhur me ndërtimin pa leje të murit nuk jeni shprehur me vendim në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore.

Në kuptim të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007, të ndryshuar, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, ka rezultuar se, duke zbatuar jo në mënyrë korrekte ligjin jeni mjaftuar vetëm me mbajtjen e proces-verbalit datë 08.08.2022, ku keni bërë pezullimin e punimeve me qëllim që shtetasi N.K të pajiset me leje ndërtimi, pa përcaktuar afatin kohor përkatës. Evidentojmë faktin se me konstatimin e kundërvajtjes, brenda afatit 10 ditë nuk ka patur vendimarrje nga ana juaj për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative. Sipas nenit 13, pika c, vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim shoqërohet me vendim për dënimin me gjobë, sipas parashikimeve ligjore.

Përgjatë trajtimit të rastit në kuadër të hetimit administrativ ka rezultuar se veprimtaria administrative e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Finiq, në procesin e trajtimit të rastit nuk është zhvilluar në përputhje me parimet ligjore mbi bazë të të cilit është normuar veprimtaria e këtij organi. Ushtrimi i detyrave sikurse parashikuar në ligj, është i detyrueshëm në këtë situatë në të cilën ndodhet çështja e prezantuar, pasi nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Finiq, nuk është respektuar dhe nuk respektohet detyrimi për ushtrimin e përgjegjësisë ligjore e detyrave specifike të sanksionuara në ligj. Në këtë kontekst, ju nuk keni ushtruar kompetencat tuaja konform nenit 52/4 dhe 52/6, të ligjit nr.107/2014, *“Për Planifikimin e Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar. Në nenin 52/4 të ligjit të mësipërm parashikohet se: *“kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera”*. Ndërsa në nenin 52/6 të po këtij ligji është parashikuar se : *“Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit”*. Gjithashtu nuk keni vepruar konform V.K.M-së Nr. 894, datë 4.11.2015 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të Territorit nga Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”*, e në mënyrë specifike me pikat 6 dhe 7 të këtij vendimi. Konkretisht në pikën 6 të tij është parashikuar se: *“Vendimi i dënimit me gjobë merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim dhe nuk pengon marrjen e një vendimi të dytë për pezullimin e punimeve në ndërtim apo të vendimit për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm*. Vendimi i dënimit me gjobë mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqërues të vendimit. Ndërsa në pikën 7 të tij është parashikuar se: *“Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i*

pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pas pezullimit të punimeve, shtetasi N.K ka kërkuar leje ndërtimi për rindërtimin e murit, në bazë të projektit dhe relacionik teknik të vlerësuar nga inxhinieri konstruktor D.B. Leja është dhënë më datë 09.08.2022, me nr. 2042/1 prot..

Në vijim muri që është ndërtuar është ankimuar sërish nga shtetasi Th.K me pretendimin se është ndërtuar në sipërfaqe dhe përsëri paraqet rrezikshmëri pasi nuk është i qëndrueshëm.

Nisur sa sipër, Bashkia Finiq nëpërmjet shkresës nr.2584 prot., datë 31.10.2023, i ka kërkuar inxhinierit S.L kërkesë për bashkëpunim në lidhje me objektin në fjalë. Në raportin gjeologjik të hartuar në nëntor 2023 nga ing. gjeolog z. S.L është rekomanduar ndër të tjera: “*Prishja e murit ekzistues në të gjithë gjatësinë që përfshin kufirin e përbashkët të pronarëve Th.K dhe K.K.*”

Ndërsa me shkresën nr.366 prot., datë 13.02.2024, lidhur me ankesën e bërë nga ankuesi keni kërkuar bashkëpunim dhe dhënien e mendimit për një zgjidhje teknike të rastit ing. D.B. Edhe sipas aktit të ekspertimit teknik të datës 20.06.2024 ing. D.B ka rekomanduar: Prishjen e murit në zonën e përbashkët i cili nuk është i qëndrueshëm, si dhe kthimin e sheshit në gjendjen e mëparshme duke nxjerrë bazamentin e themelit ose heqjen e materialit të dëmtuar. *Ndërtimin e murit të ri sipas projektit të rekomanduar në Bashki për lejen e ndërtimit.*

Në rastin konkret konkludojmë se muri i ndërtuar nga ana e shtetasit Niqifor nuk është konform lejes së ndërtimit nr. 2042/1 prot, datë 08.09.2022, sipas projektit të bërë nga ing. D.B. Kjo rezulton edhe në shkresën tuaj nr. 2552 prot datë 15.10.2024, ku referoni se terreni është i pjerrët dhe paraqet rrezikshmëri. Nga konstatimi i bërë rezulton se ky mur nuk është ndërtuar konform kushteve teknike pasi themeli nuk është i hapur deri në bazament, por ishte hedhur shtresë betoni mbi të cilin është ngritur muri i gurit.

Evidentojmë faktin se, përgjatë kësaj periudhe nuk janë ndërmarrë hapa konkretë për zgjidhjen e problemit sipas rekomandimeve teknike të specialistëve të fushës. Bazuar në kompetencat që IMT-së, të Bashkisë Finiq i jepen nga ligji vlerësojmë se masat e marra prej këtij organ publik nuk i janë përgjigjur situatës në terren. Përgjatë hetimit administrativ lidhur me rastin ka rezultuar se ka patur veprime apo mosveprime të të IMT-së, Bashkisë Finiq, të cilat nuk kanë qenë në korelacion me kryerjen e detyrave funksionale dhe në përputhje me kompetencat e këtij organi, sikurse janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre, ushtrimi i të cilave është i detyrueshëm ³ për të.

Në këtë kontekst, ushtrimi i kontrollit në rastin në fjalë ka qenë dhe është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm në kuadër të zbatimit të lejes së ndërtimit, por edhe të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës, apo pasurisë së njerëzve me qëllim që ndërtimi të mos paraqesë rrezik shembje.

³ Neni 22/2 i Kodit të Procedurës Administrative.

Nisur nga pjerrësia e terrenit, si dhe pozicionimi i pronës, gjykojmë se nuk është vlerësuar me përgjegjshmëri nga ana juaj kjo situatë si dhe nuk janë marrë veprimet e duhura ligjore pas pas vënies dijeni me të, për të shmangur rrezikshmërinë që paraqiste situata në terren.

Ndërsa lidhur me qëndrimin tuaj se ky nuk është një ndërtim pa leje evidentojmë faktin se ky është një ndërtim në shkelje të lejes, pasi nuk ishte ndërtuar konform kushteve teknike, sipas projektit të miratuar në Bashki për marrjen e lejes së ndërtimit. Kjo rezulton edhe nga akti i ekspertimit teknik të ing. D.B. Edhe në këtë rast nga ana e IMT-së Bashkisë Finiq nuk janë ushtruar si duhet kompetencat e saj në ushtrim të detyrave dhe përgjegjësive të saj, pasi nuk ka ushtruar kontrolle lidhur me zbatueshmërinë e lejes së ndërtimit, sipas projektit të miratuar nga organi kompetent, sikurse parashikuar në nenin 12, paragrafi 8, gërma “a” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar.

Në kushtet kur eksperti ka rekomanduar : Prishjen e murit në zonën e përbashkët pasi nuk është i qëndrueshëm, si dhe kthimin e sheshit në gjendjen e mëparshme duke nxjerrë bazamentin e themelit ose heqjen e materialit të dëmtuar. Ndërtimin e murit të ri sipas projektit të rekomanduar në Bashki për lejen e ndërtimit, vlerësojmë se veprimtaria juaj duhej të ishte fokusuar në përmbushje edhe të detyrimeve që rrjedhin nga neni 12, pika 8, gërma “c”, e ligjit të mësipërm i cili parashikon se: “Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit tw njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë të përfshij në kontrollin e tij prishjen e një ndërtimi ekzistues, ndërtimin apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore, si dhe punimet/ndërtimet, që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve”.

Nisur nga situata emergjente sa sipër përshkruar që ka të bëjë me paqëndrueshmërinë e murit si dhe rrezikut të rrëshqitjes së tij, ju duhej të kishit ndërhyrë për të zgjidhur këtë problematikë konform parashikimeve ligjore. Në përmbushjen e përgjegjësive ligjore të parashikuara në ligj, ju mbështeteni nga policia e njësisë vendore si dhe pajiseni me mjete dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore, sikurse është parashikuar në nenin 4, paragrafi 3, të ligjit nr. 9780 datë 19.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, të ndryshuar.

Sikurse evidentohet në këtë rast kemi të bëjmë me mosveprim të vazhduar, të organit tuaj publik, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Zbatimi i ligjit dhe kompetencave që rrjedhin prej tij nuk duhet lejuar të bëhen çështje dëshire nga punonjësit të cilëve iu ngarkohet kjo detyrë, pasi rigoroziteti i kërkuar në këtë drejtim bëhet gjithmonë shkak për kërkimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale. Ky mosveprim nuk jep imazhin e kërkuar të një organi publik në shërbim të qytetarëve, por të një organi publik që zvarrit zgjidhjen dhe bëhet shkak i shkeljes së të drejtave të individëve.

Në procesin e ndërmjetësimit nga ana jonë, për zgjidhjen e kësaj çështjeje duam t'ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik sikurse edhe ju, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre dhe jo të bëhen shkak me mosveprimin e tyre, në vazhdimin e shkeljes dhe mosrespektimit të këtyre të drejtave.

Detyrimi për mbrojtjen e pronës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj, sikurse edhe në këtë çështje, është sanksionuar shprehimisht edhe në paragrafin e parë, të nenit 1, të protokollit 1, të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku citohet se:

“Çdo person fizik, ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : “ Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime ..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”;

REKOMANDOJMË:

- Ushtrimin nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të Bashkisë Finiq, të përgjegjësive, të përcaktuara në ligjin nr.9780 datë 16.07.2007 2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin specifik, rregullator, në fuqi, për trajtimin e ankesës së shtetasit Th.K Kallojeri.

- *Marrjen e masave për mospërsëritjen e kësaj praktike në të ardhmen, në procedurat administrative që do të ndiqen nga ana juaj për trajtimin e çështjeve të tjera, brenda juridiksionit dhe kompetencave të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të Bashkisë Finiq.*
- *Analizimin e këtij rasti nga strukturat përkatëse me qëllim hartimin e një udhëzuesi lidhur me mënyrën e trajtimit të rasteve emergjente për prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në rastet e ndërhyrjes emergjente, përsa i përket banesave të braktisura, ose banesave pronarët e të cilëve nuk gjenden në banesë, për arsye të ndryshme.*

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

KOMISIONERE

ERINDA MELI

d.v